



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1036/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “FE DOORS” SH.P.K., me NUI:811409491, me seli në Prizren, rruga “Barutane” p.n, përfaqësuar sipas autorizimit nga Visar Ostrozubi, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “EURO-GROUP” SH.P.K., me NUI:810030669, me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123” p.n, përfaqësuar nga E.G., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.256/23 të datës 15.06.2023, të Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datës 12.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “EURO-GROUP” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.256/23 të datës 15.06.2023, të Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.256/23 i datës 15.06.2023, i Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “FE DOORS” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.256/23 të datës 15.06.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. FSM-21-000054 të datës 17.05.2021, Faturës Nr. FSM-22-000149 të datës 02.12.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 15,000.00 €, ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, deri në pagesën e shumës së kërkuar për përmbartim duke llogaritur edhe kumatën nga dita e pranimi të urdhrin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe

shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar ndër të tjerash se urdhri përmbartimor është i pabazuar pasi që debitori me kreditorin kanë qenë në marrëdhënie kontraktore në mes veti, dhe menjëherë pas pranimin të propozimit për përmbartim të kreditorit, debitori ka bërë rishikimin e dokumentacionit lidhur me mënyrën e pagesës për mallin e blerë dhe ka vërejtur se për këto fatura në lidhje me mallin e blerë nga kreditori, janë pajtuar që pagesa të bëhet pas pranim – dorëzimit të mallit, respektivisht montimit të dyerve të porositura. Tutje ka shtuar se kreditori nuk ka bashkangjitur edhe procesin e pranim dorëzimit të mallit dhe për këtë palët fillimisht është dashur të bëjnë barazimin e pranimin të mallit dhe pagesave të kryera deri më tani, për shkak se palët kanë qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm. Meqenëse debitori nuk e ka pranuar mallin nga kreditori, sipas marrëveshjes për këtë arsye nuk është bërë pagesa nga debitori. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbartimit.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga debitori. Tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe kanë për qëllim prolongimin e çështjes dhe mos pagesën e obligimeve ligjore që rrjedhin nga marrëdhëniet ligjore juridike, pasi që mallrat janë dorëzuar tek debitori së bashku me faturat në vlerë prej 15,000.00 €, fatura të cilat janë dokument i besueshëm, të njëjtat janë lëshuar nga kreditori dhe janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet urdhri përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të të cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr. FSM-21-000054 të datës 17.05.2021 dhe Faturën Nr. FSM-22-000149 të datës 02.12.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. FSM-21-000054 e datës 17.05.2021, dhe Fatura Nr. FSM-22-000149 e datës 02.12.2022, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, si dhe nuk janë kontestuar.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1036/23, datë 12.10.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.